

TE DREJTAT DHE PERGJEGJESITE E KLIENTIT DHE AVOKATIT

1. Takohuni me avokatin sa me shpejte qe te jete e mundur pasi te keni marre Formularin e Informacionit Personal (FIP) nga Bordi i Imigracionit dhe Refugjateve (BIR). Ju dhe avokati juaj keni vetem 28 dite qe te plotesoni FIP dhe ta dorezoni ate ne BIR.
2. N.q.s. ju vjen nje certifikate vetem per nje leter opiniononi te avokatit, Ndihma Ligjore do te paguaje avokatin tuaj qe te shqyrtoje kerkesen tuaj per refugjat dhe te jape nje opinion rreth saj. Ndihma Ligjore me pas do te vendose nese do te paguaje avokatin tuaj per te pergatitur FIP dhe per t'ju perfaqesuar juve ne séance. BIR e ben te detyrueshem afatin 28 dite si afatin e fundit per dorezimin e FIP edhe n.q.s Ndihma Ligjore i kerkon avokatit tuaj nje leter opiniononi.
3. N.Q.S. juve ju vjen nje certificate per pergatitjen e FIP dhe prezantimit perpara BIR, Ndihma Ligjore do te paguaje avokatin tuaj per keto sherbime. Ju nuk duhet te paguani avokatin per keto sherbime. Certifikata mbulon nje numer te caktuar oresh per pergatitjen (16 ore per nje séance te plote dhe 8 ore per nje séance te pershpejtuar). Kufiri kohor per punen e avokatit ne lidhje me rastin tuaj perfshin cdo pune te kryer nga nje nepunes ligjor/paraligjor. Kufijte kohore perfshijne edhe kohen e punes se perkthyesve.
 - Avokati juaj duhet t'ju marre juve ne interviste personalisht per permbajtjen e FIP tuaj perpara se sa ju ta firmosni ate.
 - Ne te gjitha takimet, avokati juaj duhet te kete nje perkthyes n.q.s. juve keni nevojte. Ndihma Ligjore do te paguaje per perkthyesin (deri ne 10 ore, ose me shume n.q.s. avokati merr aprovimin). Ju nuk duhet te paguani per perkthyesin.
 - Perpara se ta firmosni formularin, sigurohuni qe FIP eshte i gjithi i plotesuar, i sakte ne cdo detaj dhe se e kuptoni cdo gje ne te. FIP eshte deklarata juaj, keshtu qe pritet qe ju ta kuptoni ate. Ju keni te drejte ta korrigjoni FIP, nese eshte e nevojshme, perpara se sa ta firmosni.
 - Avokati juaj duhet t'u jape juve nje kopje te FIP-se te plotesuartuar, te firmosur prej jush dhe te derguar ne BIR.
 - N.q.s. avokati juaj mendon se per seancen eshte i nevojshem edhe nje raport mjekesor apo psikologjik, ai do t'ju dergoje te nje doktor apo psikolog per te marre nje te tille. Ndihma Ligjore do te paguaje avokatin tuaj per kete raport deri ne nje shume te caktuar. Ju nuk duhet te paguani per kete raport.
 - Dokumentat qe nuk jane ne anglisht apo frengjisht, duhet te perkthehen perpara se sa te dergohen ne BIR. N.q.s dokumenti juaj i identitetit apo dokumentat te tjera personale kane nevojte te perkthehen, bisedoni me avokatin. Ndihma Ligjore do te paguaje per nje sasi te kufizuar perkthimi. N.q.s keni me shume dokumenta qe kane nevojte per perkthim, avokati juaj mund te pyesi Ndihmen Ligjore qe te paguaje per me shume perkthime.
 - Avokati juaj duhet te takohet me ju qe t'ju pergatise per seancen dhe te shkoje me ju ne séance, me perjashtim te rastit kur ju bini dakort te perfaqesoheni nga nje avokat tjetër, apo nga nje student i drejtësisë, i mbikqyrur drejtpersdrejti nga avokati juaj.
 - Avokati juaj duhet t'u thote juve se kush do te punoje nen certifikaten tuaj te ndihmes ligjore, kush do te pergatise FIP tuaj se bashku me ju dhe kush do te shkoje me ju ne séance si dhe duhet t'ju thote nese ai person eshte avokat apo jo.
4. Njoftoni Ndihmen Ligjore, avokatin tuaj, BIR, dhe Departamentin e Imigracionit nese nderroni adresen apo numrin etelefonit.

Ju lutem pyesni avokatin nese ai/ajo eshte ne panelin e Ndhimes Ligjore per Refugjatet te Ontarios dhe mund te pranoje certifikaten tuaj , nese ju vjen nje e tille. N.q.s. keni ndonje pyetje apo shqetesim, shkoni perseri ne zyren ku aplikuat per ndohme ligjore.